

Në bazë të nenit 5 të rregullorës së punës së Këshillit Drejtues thërras mbledhjen e nëntë me radhë të Këshillit Drejtues të Akademisë dhe propozoj këtë:


REND DITE

1. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e tetë;
2. Aprovimi i hartimit të RVV-ve për tri programe për ri-akreditim dhe RVV-së për ri-akreditim institucional.
3. Rishikimi i rregulloreve
4. Rishikimi i misionit dhe shqyrtimi i planit të monitorimit të Planit Strategjik
5. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 29.09.2023 (e premte) në ora 10:00.

Kryetari i Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



E K S T R A K T

Nga mbledhja e tetë e Këshillit Drejtues të mbajtur me datë 29.09.2023, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi –Kryetare e e Këshillit Drejtues.
2. MSc.Sara Fusha Osmani - Zëvendës Kryetare e Këshillit Drejtues
3. MSc. Lutfi Gashi – anëtar nga shoqëria civile
4. MSc. Sami Mazreku – anëtar Këshilli i Partënerëve
5. Arsim Zagragja-anëtar nga Parlamenti Studentor i Akademisë
6. Dr.Sc.Muhamed Krasniqi Drjtor i Akademisë – anëtar pa të drejtë vote;
7. Fatime Krasniqi Sekretare e Përgjithshme e Akademisë - anëtar pa të drejtë vote

Mbledhjen e hapi Kryetarja e Këshillit Drejtues Dr.Sc. Ema Berisha e cila i falënderoj për prezencën anëtarët e Këshillit dhe propozoi per miratim këtë:

REND DITE

1. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e tetë;
2. Aprovimi i hartimit të RVV-ve për tri programe për ri-akreditim dhe RVV-së për ri-akreditim institucional.
3. Rishikimi i rregulloreve
4. Rishikimi i Planit Strategjik te Akademisë
5. Të tjera.

Rendi i ditës i propozuar u miratua unanimisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

I. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e tetë

Kryetarja Znj. Berisha hapi diskutimin lidhur me Ekstraktin nga mbledhja e tetë, të pranishmit nuk patën asnjë vërejtje apo sygjerim lidhur me Ekstraktin e mbledhës së kaluar të Këshillit prandaj Dr.Sc. Ema Berisha propozoi për votim. Ekstrakti u miratua unanimitisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

II. Aprovimi i hartimit të RVV-ve për tri programe për ri-akreditim dhe RVV-së për ri-akreditim institucional.

Kryetarja e Këshillit Drejtues Zj. Berisha hapi diskutimin në pikën e parë të rendit të ditës. Meqenëse në vitin e ardhshëm në skadon afati i akreditimit të programeve në nivelin bachelor dhe master atëherë propozoj që të hartohen raportet e vetvlerësimit të programeve të studimit (RVV) të cilat janë propozuar nga Këshilli Akdemik (KA) i Akademisë. Fjalën e mori drejtori i Akademisë, z. Muhamet Krasniqi, i cili ishte dakord me propozimin e Kryesueses si dhe shtoi se duhet të hartohet edhe raporti i vetvlerësimit institucional për Akdeminë. Nga anëtarët tjerë nuk patën për të shtuar prandaj unanimitisht votuan në pikën e dytë të rendit të ditës.

III. Rishikimi i rregulloreve

Zj. Berisha, vazhdoi me pikën e tjetër të rendit të ditës. Sekretarja e Akademisë, znj. Fatime Krasniqi mori fjalën dhe propozoi rishikimin e rregulloreve duke pasur parasysh se ka kaluar një kohë dhe gjatë procesit kemi vërejtur se disa nga rregulloret kanë nevojë për disa plotësime/ndryshime. Komisioni për akte normative duhet të jetë përgjegjës për këtë punë dhe në fund të rishikimit duhet ti sjellë në këshill për miratim.

Anëtarët tjerë nuk patën diskutime dhe në mënyrë unanime u miratua për rishikimin e rregulloreve.


IV. Rishikimi i misionit dhe shqyrtimi i planit të monitorimit

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja e Këshillit Drejtues hap diskutimin, lidhur me misionin, ku u dakorduan që misionit të akademisë duhet të rishikohet për të formuluar rolin e tretë të institucionit në një mënyrë më të qartë dhe të drejtpërdrejtë, si dhe duhet të shqyrtohet plani i monitorimit të Planin Startegjik. Drejtori i Akademisë, z. Muhamet Krasniqi propozoj që misioni të rishikohet dhe plani i monitorimit të jete prioritet në mënyrë që të shihet harmonizimi i tij me punët e arritura deri më tani në Akademi si dhe me planëprogramet e Akademisë. Anëtarët e akademisë u pajtuan prandaj propozuan për votim. Kryetarja e hodhi në votim vendimin dhe u votua unanimisht nga të gjithë anëtarët.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15.

Të tjera nuk pati në këtë takim.

Kryetarja e Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



Procesmbajtësi:
Zj. Blerina Dragusha
